

KTHIMI PRAPA NË "NORMALITET": EKZAMINIMI I REZILIENCËS TEK FËMIJËT DHE  
ADOLESHENTËT NË KONTEKSTIN E RREZIQEVE MJEDISORE

TEMA PËR TITULLIN  
MASTER I ARTEVE NË PSIKOLOGJI SHKOLLORE DHE KËSHILLIM

NGA

DIADORA CËRMJANI



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
FAKULTETI FILOZOFIK  
DEPARTAMENTI I PSIKOLOGJISË  
PRISHTINË

KORRIK, 2021

Kthimi prapa në "Normalitet": Ekzaminimi i Reziliencës tek Fëmijët dhe Adoleshentët në  
Kontekstin e Rreziqeve Mjedisore

Diadora Cërmjani

Mentori: Dashamir Bërxulli, Prof. Asoc. Dr.

Megjithëse ka shumë studime (Perry, 2002; Greene, 2002; Bonanno, 2004) që flasin për reziliencën si konstrukt i zhvilluar tek individët e rritur, rezilienca e fëmijëve dhe adoleshentëve në kontekstin e rreziqeve mjedisore duket të jetë një fushë unike e cila duhet të mirret parasysh. Ky studim është i pari në llojin e vet, që synon të kuptojë reziliencën si konstrukt zhvillimor tek fëmijët dhe adoleshentët në kontekstin e rreziqeve mjedisore, përtej traumave të fëmijërisë, abuzimeve, apo luftërave. Studimi aktual është zhvilluar për të shqyrtuar ndikimin e pandemisë Covid-19 dhe distresit psikologjik në mjedisin shkollor në reziliencën dhe mirëqenien e fëmijëve dhe adoleshentëve kosovar. Në këtë studim, mosha e fëmijëve dhe adoleshentëve të studiuar ka variuar nga 10 në 18 vjeç, të gjithë nxënës të regjistruar në shkollimin fillor dhe të mesëm në komunat përkatëse në Kosovë.

Meqenëse fëmijët rezilientë paraqesin një lulëzim emocional dhe kognitiv kundrejt fatkeqësive, koncepti i reziliencës është i një rëndësie të madhe për prindërit, mësuesit dhe profesionistët shëndetësor për të cilët zhvillimi pozitiv i të rinjve ka rëndësi jetike. Duke u nisur nga kjo, pyetjet kërkimore dhe hipotezat përkatëse të studimit janë definuar si në vijim:

1. Cila është ndërlidhja mes pandemisë Covid-19 dhe ndikimit në mirëqenien psikologjike të fëmijëve dhe adoleshentëve kosovar?

H1: Ekziston ndërlidhje signifikante negative mes pandemisë Covid-19 dhe mirëqenies psikologjike të fëmijëve dhe adoleshentëve kosovar.

1.1. Cili është ndikimi që pandemia Covid-19 ka për kapacitetin e fëmijëve dhe adoleshentëve kosovar për reziliencë?

H1.1a: Izolimi social, si faktor i shoqëruar me pandeminë Covid-19, ka ndikim signifikant negativ në kapacitetin për reziliencë tek fëmijët dhe adoleshentët kosovar.

H1.1b: Frika nga infektimi, si faktor i shoqëruar me pandeminë Covid-19, ka ndikim signifikant negativ në kapacitetin për reziliencë tek fëmijët dhe adoleshentët kosovar.

H1.1c: Mbështetja e pamjaftueshme nga familjarët, bashkëmoshatarët dhe mësimdhënësit, si faktor i shoqëruar me pandeminë Covid-19, ka ndikim signifikant negativ në kapacitetin për reziliencë tek fëmijët dhe adoleshentët kosovar.

2. Cili është ndikimi i distresit psikologjik në shkollë si rrezik psiko-social në mirëqenien psikologjike të fëmijëve dhe adoleshentëve kosovar?

H2: Distresi psikologjik në mjedisin e shkollës paraqet ndikim të moderuar negativ në mirëqenien psikologjike të fëmijëve dhe adoleshentëve kosovar.

2.1. Cili është ndikimi i rreziqeve psiko-sociale në mjedisin e shkollës në kapacitetin e fëmijëve dhe adoleshentëve kosovar për reziliencë?

H2.1: Distresi psikologjik, si rrezik psiko-social i shoqëruar me mjedisin e shkollës, ka ndikim signifikant negativ në kapacitetin për reziliencë tek fëmijët dhe adoleshentët kosovar.

3. Cili është ndikimi i faktorëve kyç mbrojtës në zhvillimin e reziliencës tek fëmijët dhe adoleshentët kosovar?

H3a: Shkathtësitë personale, kanë ndikim signifikant pozitiv në zhvillimin e reziliencës tek fëmijët dhe adoleshentët kosovar.

H3b: Marrëdhëniet e mira me familjarët, kanë ndikim signifikant pozitiv në zhvillimin e reziliencës tek fëmijët dhe adoleshentët kosovar.

H4c: Mbështetja nga bashkëmoshatarët, ka ndikim signifikant pozitiv në zhvillimin e reziliencës tek fëmijët dhe adoleshentët kosovar.

H5d: Marrëdhëniet pozitive me mësimdhënësit, kanë ndikim signifikant pozitiv në zhvillimin e reziliencës tek fëmijët dhe adoleshentët kosovar.

Për t'i dhënë përgjigje pyetjeve kërkimore dhe për të konfirmuar hipotezat e studimit, janë performuar analizat e korrelacionit dhe regresionit, përmes Paketës Statistike për Shkencat Sociale (SPSS). Rezultatet e studimit aktual tregojnë se ekziston një ndërlidhje signifikante të fuqishme pozitive në mes të reziliencës dhe mirëqenies psikologjike,  $r(227) = .000$ ,  $p < .01$ . Rezultatet nuk kanë gjetur ndërlidhje signifikante  $r(226) = .000$ ,  $p < .01$ , dhe ndikim signifikant  $F(1,202) = 4.238$ ,  $p > .05$ , midis pandemisë Covid-19 dhe mirëqenies psikologjike, duke mos konfirmuar kështu hipotezën e parë të studimit. Për më tepër, rezultatet zbuluan se nuk kishte ndonjë ndërlidhje signifikante midis pandemisë Covid-19 dhe reziliencës  $r(204) = .069$ ,  $p > .05$ , dhe as ndonjë ndikim signifikant  $F(1,202) = 3.350$ ,  $p < .05$ . Përkundrejt kësaj, izolimi social si masë e ndërmarrë ndaj mbrojtjes prej Covid-19, rezultoi të ketë ndërlidhje signifikante pozitive  $r(200) = .035$ ,  $p > .05$  dhe ndikim signifikant  $F(1,198) = 4.491$ ,  $p < .0$  në kapacitetin për reziliencë. Njëkohësisht, të dhënat tregojnë se ekziston një ndërlidhje signifikante pozitive në mes të reziliencës dhe nënshkallës frika nga infektimi të Covid-19,  $r(203) = .012$ ,  $p > .05$ . Për më tepër, rezultatet konfirmojnë edhe ndikimin që ka frika nga infektimi në kapacitetin për reziliencë tek fëmijët dhe adoleshentët,  $F(1,201) = 6.380$ ,  $p < .05$ .

Tutje, rezultatet e këtij studimi tregojnë për një ndërlidhje signifikante të fuqishme negative në mes të reziliencës dhe distresit psikologjik në mjedisin e shkollës,  $r(231) = .000$ ,  $p < .01$ . Kjo

nënkupton që sa më i lartë distresi psikologjik brenda këtij mjedisi, aq më e ulët rezilienca e fëmijëve dhe adoleshentëve. Për më tepër, rezultatet dëshmojnë se ekziston një ndikim signifikant i distresit psikologjik në kapacitetin për reziliencë te fëmijët dhe adoleshentët  $F(1,230)= 86.308$ ,  $p>.01$ . Këto rezultate njëherit konfirmojnë edhe të dhënat nga studimet e autorëve në Kosovë (Shahini et al., 2014; Gjoshi & Krume, 2014) që dëshmojnë se ka shqetësime në lidhje me vështirësitë dhe distresin emocional që fëmijët dhe adoleshentë përjetojnë në shkollë. Së bashku dhe me rezultatet e studimit aktual, këto të dhëna argumentojnë se mirëqenia psikologjike e nxënësve kosovar, është e ndikuar nga mjedisi shkollor dhe cilësia e të mësuarit.

Në fund, rezultatet kanë konfirmuar edhe hipotezat e pyetjes së tretë kërkimore, ku rezultatet dëshmojnë se ekziston një ndikim signifikant i shkathtësive personale të fëmijëve dhe adoleshentëve në kapacitetin e tyre për reziliencë,  $F(1,232)= 4029.162$ ,  $p<.01$ . Në të njëjtin drejtim, studimi aktual gjeti se marrëdhëniet pozitive ndërpersonale (familja, bashkëmoshatarët, mësimdhënësit), kanë një ndikim signifikant në kapacitetin për reziliencë tek fëmijët dhe adoleshentët kosovar, siç konfirmohet edhe nga analiza regresionale,  $F(1,230)= 3277.608$ ,  $p<.01$ .

Mund të konkludohet se studimi aktual, është i pari në llojin e vet, që synon të kuptojë reziliencën si konstrukt zhvillimor tek fëmijët dhe adoleshentët në kontekstin e rrezeve mjedisore, përtej traumave të fëmijërisë, abuzimeve apo luftërave. Prindërit, mësimdhënësit dhe profesionistët shëndetësor duhet të promovojnë këto efekte negative dhe të mbështesin zhvillimin adaptive të të rinjve. Sigurimi i mbështetjes për fëmijët dhe adoleshentët pas përjetimit të një rreziku mjedisor është një faktor i rëndësishëm që familjarët, akterët e shkollës dhe komuniteti duhet ta marrin parasysh që të mund t'iu ndihmojë këtyre fëmijëve dhe adoleshentëve të ndërtojnë qëndrueshmëri dhe stabilitet.